



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballshinë, 21.11.2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 13 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Znj. Etilda Dishaj, Z. Aleksandër Rama, Znj. Kleidja Hoxhaj, Znj. Aurora Heqimaj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes më datë 29.10.2025.
3. **Projektvendim Nr.41:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.42:** Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026.
5. **Projektvendim Nr.43:** Për miratimin e kompensimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit për vitin shkollor 2025-2026.

Për projektvendimin Nr.44, jeni dakord të hyj në rend dite? Ka të bëjë me privatizimin e objekteve të marra nga ish-uzina ose nga ndërmarrje të tjera, është marr Rovenë me këtë rast, privatizimi i banesave që kanë qenë objekt i ligjit 7652 "Për privatizimin e banesave shtetërore" të cilat janë privatizuar nga banorët që kanë jetuar në to, pasi kanë kaluar në inventar të bashkisë, tani kalojnë në privatizim.

Kush është dakord me këtë rend dite? Votojnë 13 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, sekretare të lutem na bëj me dije vendimet nga procesverbali i mbledhjes së kaluar.

1. **Vendim Nr.36:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

2. **Vendim Nr.37:** Për miratimin e planit të punës, planit të konsultimeve dhe planit të buxhetit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër për vitin 2026.

3. **Vendim Nr.38:** Për miratimin e linjave të transportit të mësuesëve dhe nxënësve që punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit të tyre.

Vazhdojmë me rëndin e ditës, pikën 3: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%. Kush ka ndonjë pyetje, ose sqarime, sygjerime në lidhje me materialin, jeni të mirëpritur, fjala për ju.

Z. Adrian Hazizaj: Një pyetje kisha unë, a kanë përfituar të gjithë ata që kanë aplikuar muajin e kaluar?

Znj. Kleidja Hoxhaj: Po, janë kualifikuar të gjithë.

Me qën se s'ka diskutime të tjera e hedhim me votim, votojnë 13 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

6. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Projektvendimi Nr.42: Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026.

Z. Adrian Hazizaj: Ka ndryshime nga viti i kaluar?

Z. Aleksandër Rama: Po, nga viti i kaluar janë reflektuar disa ndryshime, sipas rekomandimeve nga Prefektura e Qarkut Fier, dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pronës, për të përcaktuar më saktë, sipas VKM-së përkatëse, dhe ndryshime kanë ndodhur te tabela për ndikimin e taksës në infrastrukturë, i kemi ndarë sipas kategorive të objekteve, qendër banimi shërbimi, etj; te tarifat e bizneseve ka dy tre ndryshime të vogla, jo rritje të taksave dhe tarifave, por janë shtuar disa lloj aktiviteteve dhe biznesesh të cilat nuk i kishim të pasqyruara në vitin 2025. Këtu janë future: kampinjet, bujtinat, bizneset që operojnë në fushën e energjisë, p.sh fotovoltaiket. Ndryshimi tjetër është rifreskimi i tabelave me tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave dhe kulinaris. Për taksat e ndërtesës familjare, në Ballsh është 30 mijë/m², kurse në Njësit është 30% më pak.

Z. Oldison Caushaj: Taksa e kalimit të pronësisë?

Z. Aleksandër Rama: kjo është taks që mbliidhet nga agjentë, nuk mbliidhet nga bashkia, pra nga ASHK-ja dhe për çdo transaksion për shitje të pasurisë pronës, 97% e kësaj shume na kalon ne si e ardhur. Mbliidhet nga hipoteka me pak fjalë.

Z. Qerim Ismailaj: Ky projektvendim, pra paketa fiksale, është një nga elementët më të rëndësishëm të punës së bashkisë, patjetër dhe për këshillin bashkiak, i cili nuk ka të bëjë thjeshtë me sa të ardhura dhe sa buxhet ka Bashkia Mallakastër, por prek drejtë për së drejti qytetarët, si për taksa e caktuara me ligj gjithashtu dhe për tarifat, sepse e dim tashmë që këto janë dy elementët kryesor, taksat janë të saktësuara me ligj dhe ne kemi aplikuar pjesën më të madhe të rasteve maksimumin që lejon ligji minus 30%, për një sërë kategorish, të cilat i kemi të pasqyruara dhe te paketa fiskale. Natyrisht te tarifat kemi mbanjtur të njëjtin nivel, panvarsisht diskutimit që kemi pasur edhe me kryesinë e këshillit, kemi pasur një reflektim të ndryshimit, jo thjesht të nevojave, por kostot shtesë për kryerjen e këtyre shërbimeve, por edhe nëpër shtrirjen territoriale, si shumë shërbime që nuk kanë qën më parë dhe tani po aplikohen edhe në zonat që vite më parë nuk kanë pasur, kryesisht flas për shërbimin e pastrimit, do vazhdojmë Brenda vitit të ardhshëm, por nuk do të aplikohet tarifë, deri sa jemi duke e menduar dhe diskutuar që të jetë pjesë e buxhetit, edhe shtrirjen e ndriçimit, sidomos në fshatrat kryesor, por me synimin për ta përhapur në të gjitha fshatrat. Kuptohet që në fillim qendrat e fshatrave, sepse ka fshatra të cilët kanë shtrirje territoriale shumë të madhe dhe është e pamundur, qoftë në aspektin ekonomik por dhe në aspektin praktik, të shtrirjes së linjave, kontratave, pra është e pamundur të paktën për momentin të kemi një projekt të till, por e rëndësishme është që nga diku t'a fillojmë, dhe ne e kemi synimin t'a fillojmë këtë gjë, që krahu infrastrukturës rrugore dhe ujit të pijshëm, që kanë ecur me ritme shumë mbresëlënëse, natyrisht të futemi dhe te kjo pesa tjetër e shërbimit për qytetarët. Kjo paketë ruan të njëjtin nivel si vitin e kaluar, përjashto disa taksa të cilat janë pasqyrimi dhe i disa ndryshimeve të aktiviteteve ekonomike, të cilat nuk kanë pasur shërbim në zonën tonë, fut këtu pjesën e ndriçimit fotovoltaike, kampingjeve, sepse ne duhet t'ju paraprijmë gjërave, që në momentin që dikush thotë do ndërtoj një kamping, s'mund të mbliidhet këshilli që të përcaktojmë sa do jetë taksa apo tarifa për këtë lloj biznesi, po ju paraprijmë këtyre ndryshimeve, mqs po shkojmë drejt kësaj. Është dhe një kategori tjetër e caktuar, që ka nevoj që ne t'i paraprijmë, natyrisht janë bër disa saktësime dhe në bazë të VKM-ve përkatëse, sepse e shpjegoi drejtori ekonomik, por po sqaroj diçka, ne themi njësitë administrative në parim, por ata i duan specifikisht që çdo

njësi, këtu thjesht shtohet emërtimi i njësisive, si Hekal, Qendër, Kutë, Aranitas, por efekti financiar është i njëjti, siç e kemi lën për Ballshin dhe për njësitë e tjera, janë bër saktësimet nga ana gramatikore, por nuk ndryshojnë thelbin e tarifës, tarifa dhe taksa është e njëjtë me atë që ka qen më përpara me ato lehtësirat që janë krijuar. Tarifat do aplikohen sipas zonës së shtrirjes së shërbimit, p.sh pastrami, ndriçimi i fshatrave në qendrat e tyre. Totali i tarifave për një familje është 3500 lekë/vit, përtej taksës po flas për pjesën e tarifave të shërbimit, pra 3500 nuk është ndonjë barr e rënd për familjet, por natyrisht kemi një pjesë kategorish që përjashtohen nga këto, ata që marrin ndihmë ekonomike, pensionistët e vetmuar, etj. Kjo paketë fiskale, në bazë të përlllogaritjeve, do të reflektohet dhe ne do të kemi diskutime edhe në mbledhjen pasardhëse, që do të jetë për miratimin e buxhetit dhe elementëve përkatës. Por ajo ç'ka është e rëndësishme është që kjo paketë fiskale nuk është parë kurrsesi si një element shtesë, qofshin këta familje apo biznese, por është parë si një mundësi për të pasur një taksim dhe tarifim sa më të drejtë dhe në mbështetje të qytetarëve. Kaq kisha, nëse ka diçka më specifike, jam i gatshëm të diskutojmë.

Z. Lefter Rabiçaj: Ju thoni këtu që përjashtohen nga taksat dhe tarifat vendore, sipas karekterit kombëtar, familjet që janë nën minimumin jetik, cili është ky minimum?

Z. Qerim Ismailaj: Po, këtu përjashtohen ato familje që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, pensionistët e vetmuar, sepse nuk qen pjesë e ndihmës ato nuk futen automaikisht në taksim.

Z. Lefter Rabiçaj: Thuhet që taksat dhe tarifat për bizneset në Ballsh dhe Njësinë Administrative Fratar do të jenë 3%, sikur t'i rrisni me një 0.5%?

I shtohet dhe një anëtar mbledhjes.

Z. Qerim Ismailaj: Nëse këshilli e mendon t'i rrisi, unë jam dakord.

Z. Lefter Rabiçaj: Përse agroturizmat dhe hotelet me pesë yje përjashtohen nga këto taksa?

Z. Qerim Ismailaj: Kjo është e përcaktuar me ligj, nuk është në dorën tonë. Por duhet të jenë të çertifikuar, p.sh si agroturizëm, që të jenë të përjashtuar nga taksat.

Z. Lefter Rabiçaj: Të gjitha tarifat janë sit ë vitit të kaluar, por për kurset e gjuhëve të huaja në vitin 2025 ka qen 5000 lekë, pse e keni bër 8000 mijë?

Z. Qerim Ismailaj: Nëse nuk jeni dakord për 8000 lekë e kthejmë në tarifën e mëparshme.

Z. Lefter Rabiçaj: 1- për bizneset që i keni future për herë të parë, p.sh bujtinat, dhe agroturizmat, jam i mendimit që tarifa të shtohet me 10 mijë lekë; 2.- te furrat e bukës të ulet me 10 mijë lekë, sepse po na e rrisin bukën përditë; 3- njësit e shërbimit si veterinar, klinikë dentare, farmaci, pse të tarifohen njësoj kur të ardhurat etyre s'janë të njëjta; ndërsa te ndërmarrjet e mëdha duhet parë me kujdes. P.sh sistemi fotovoltaiç, sa tarifohet vetëm 25 mijë lekë?

Përveç ndërmarrjeve të energjisë elektrike, për bizneset e naftës do parë me kujdes, duke pasur parasysh ndotjen që ju bëhet përrrenjëve dhe lumit të Mallakastrës.

Z. Qerim Ismailaj: Do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat e professor Lefterit, kurse për sa i përket paneleve, nuk i çon dot taks ndotje, sepse nuk prodhojnë ndotje, jurse mbetjet që prodhuan gjatë instalimit, ata i çuan vet në rrethgrumbullim. Bizneset e naftës janë një burim shumë i madh të ardhurash për Bashkinë Mallakastër, por kjo s'do të thotë se duhet toleruar, te pastrami nuk kemi bër asnjë lëshim.

Z. Armelin Agaj: Karburanti apo supermarket ka taks pastrami më të lart, sepse unë në biznesin tim paguaj 25 mijë lekë.

Z.Qerim Ismailja: Këto janë tarifa që vilen për të ardhurat e bashkisë, por përveç kufirit logjik është dhe ai ligjor, sepse kështu janë bërë kategorizimet. Diskutohet në parim dhe duhet trajtuar në mënyrë të barabartë, prandaj përveç ndarjes së llojit të aktivitetit është dhe ndarja sipas xhiros. P.sh një familje me pesë anëtar nuk gjeneron njësoj mbetje si një familje me dy, po kategoria është thjesht për familje, jo për frymë.

Z.Lefter Rabiay: disa zëra të tarifave të pyjet nuk përputhen me Mallakastrën.

Z. Qerim Ismailaj: duhet të jenë të parashikuara të gjitha llojet e tarifave, sepse ndodh që nesër hapet një biznes i ri që s'ka operuar më parë në Mallakastër, ne të jemi të përgatitur, që most ë na duhet të mbledhim këshillin dhe të ndryshojmë vendimin, për të shtuar dhe një lloj të re tarife.

Z.Lefter Rabiay: Ka disa firma që kryejnë punime të ndryshme, dëmtojnë rrugët dhe si kthejnë në gjendjen e mëparshme, ju lutem të ndërhyni.

Z.Bejkush Haxhiaj: Për fabrikat e vajit, gjrobat për ndotjen e mjedisit, pika 13 dhe 14, më duket shumë e ulët.

Z.Aleksandër Rama: këto tabela janë përllogaritur sipas materialeve që ka sjellë çdo drejtori.

Z.Qerim Ismailaj: Nëse ka ndotje, relatohen pran IMT-së dhe M.Mjedisit, sivjet fabrikat e vajit e marrin lejen në bashki, më parë ka qenë në ministri. Dje janë aplikuar dy gjoba për fabrikat e vajit.

Znj. Lindita Ymeraj: Te pika 10 e tarifave, për tavolinat jashtë lokaleve që tarifohen me 400 lekë, këto janë të ardhura që i shtohen bashkisë por duhet të jenë të kontrolluara dhe most ë pengojnë tortuarin, duhen shmatur sa më shumë.

Z.Qerim Ismailaj: Jo, sepse kemi dy vende ku operohet me tavolina jashtë; te pallati i kulturës dhe te ish-agjensia.

Z.Oldison Caushaj: Në rrugën nga spitali deri poshtë në qendër nuk ka asnjë vendparkim.

Z.Qerim Ismailaj: Ky është problem vetëm për këdo, por para shkollave dhe në rrugën drejt spitalit nuk mund të bëhen vendparkime, nëse doni parkim e çojmë atje poshtë te shinat e trenit.

Z.Armand Hasanbashaj: Pika 5 tabela nr.30, pse nuk bëhet gjoba nga 15-30 mijë lekë.

Z.Qerim Ismailaj: kjo është thjesht gjobë, pastaj përveç kësaj bëhet dhe vlerësimi i dëmt, kurse autori kalon në ndjekje penale. Madje ndezja e zjarrit nga 1 Maji- 10 Tetor, në zonat e hapura, përbën vepër penale.

Z.Armelin agaj: te pallati përball shkollës së mesme, kemi problem të parkojmë makinën para shtëpisë, sepse laboratory ka vënë hekura, plus që dhe mësuesit që shkojnë me makinë në punë parkojnë atje.

Z.Qerim Ismailaj: Jam marr me këtë rast, e diskutojmë në fund, le të kalojmë te rendi i ditës, të lutem.

Z.Nexhmi Sulaj: Jeni dakord me propozimet e prf.Lefterit, përveç tarifës së fuurave të bukës, të tjerat të meeren parasysh?

Hidhet në votim; votojnë 14 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet.

Atëherë kalojmë në votim të gjithë paketës, pra të projektvendimit; votojnë 14 pro, 0 kundër, 0 apstenim. Miratohet.

Z.Nexhmi Sulaj: Kalojmë në pikën pesë të rendit të ditës, Për miratimin e kompensimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit për vitin shkollor 2025-2026.

Z.Qerim Ismailaj: Kjo është vetëm për nxënësit, dhe jepet një vlerë prej 100 lekësh në ditë, për vështirësinë e transportit që ata kanë, duke ndihmuar familjet e tyre e duke nxitur që t'i dërgojnë fëmijët në shkollë.

Hidhet në votim; votojnë 14 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Z. Nexhmi Sulaj: vazhdojmë me projektvendimin e ardhur jashtë rendit të ditës, por që ju ishit dakord për t'a shqyrtuar në këtë rend, projektvendimi nr.44: Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurisë me nr. 3/70+1-16, apartament, ZK 1090, Lagjia "18 Prilli", Ballsh, Bashkia Mallakastër.

Znj. Aurora Heqimaj: Kjo është një procedur që duhet të kaloj hap pas hapi në këshill, për të bër të mundur certifikim e kësaj prone, e cila i është dhën Z.Shpëtim Alushi nga nafta, në emër të këtij personi dhe më pas të bëhet kalimi te personi që e ka momentalisht.

Ngrihet një komision , dhe nga inventari i pronave që është në emër të bashkisë do t'ju kaloj pronarëve. Ky pallat ndodhet përball gjimnazit të vjetër, dhe për apartamentin në fjalë është i interesuar Z.Muhamet Xhaferaj, vlerat e këtyre shërbimeve i takojnë këtij personi.

Hidhet në votim, votojnë 14 pro, 0 kundër 0 apstenim, miratohet.

Mbyllet këtu mbledhja e këshillti për sot, faleminderit për przencën dhe diskutimet.

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT
SEKRETARI I KËSHILLIT**

Zinaida Ahmetaj

